# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-413617**
VERSIONI

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | E goditi rrufeja sapo doli nga shtëpia, kamerat filmuan momentin dramatik (VIDEO) – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/e-goditi-rrufeja-sapo-doli-nga-shtepia-kamerat-filmuan-momentin-dramatik-video/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 6 shtator 2026, 17:48:32 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 2 shtator 2026, 07:25:17 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | a71168373145fed61ce5a4671591b3c0681fea22da43736d84c450e55062618b |
| TEKSTI | dbbad1ab0144e65e5b079e577c8651e9043b82d2f3e8a83d8d21474b06762120 |
| PAMJA | 3d2a179a93a92051e8b9f3ed8f376d83ff1736c11f6ce77b3a3e044b3d68ef08 |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | 43aa683fc61640388458194c48d12820b88f23aa3e3d50ad5793baf1d751ab09 |
| E MËPARSHMJA | c6cf9a12fd4fa46a38172f8f51c4bbc4a7041891f678f5ee830329a2b28c92b3 |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/43aa683fc61640388458194c48d12820b88f23aa3e3d50ad5793baf1d751ab09`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Një burrë nga Staten Island, Nju Jork, ka shpëtuar mrekullisht pasi u godit nga rrufeja vetëm pak metra larg makinës së tij. Thomas Fahmy po ecte në Todt Hill Road pranë Windsor Road, kur një goditje e fuqishme e rrëzoi përtokë. Kamerat e sigurisë kanë kapur momentin kur ai papritur bie në tokë.

Fahmy tha se ndjeu një tronditje të fortë në të gjithë trupin, të shoqëruar me djegie, mpirje, therje dhe dhimbje të forta në të dyja këmbët. Pavarësisht goditjes, ai nuk humbi ndjenjat dhe arriti të ngrihej e të kërkonte ndihmë. Një banore, Stephanie Homan, dëgjoi thirrjet e tij për ndihmë dhe i shkoi menjëherë në ndihmë.

> **Staten Island man struck by lightning while walking to a dentist appointment.**
> **Thomas Fahmy says he is grateful to be alive and went to church on Sunday to thank God for giving him another chance.**
> **"Once the lightning bolt struck me, the initial sensations that I had throughout…**
> **pic.twitter.com/Ns11TGqB23**
> **— Collin Rugg (@CollinRugg) September 1, 2026**

Edhe pse nuk pësoi djegie të dukshme apo dëmtime të rënda, Fahmy u dërgua në Staten Island University Hospital, ku qëndroi nën vëzhgim gjatë natës dhe u lirua të nesërmen. Ai punon në zyrën e kongresmenes amerikane Nicole Malliotakis, e cila shprehu lehtësim që ai kishte shpëtuar

5 "Dhemballa e pjekurisë mund të shkaktojë tumor", kirurgu oral: Kur...

NEWSLETTER
**Përmbledhja e ditës në e-mail**
emaili juaj
Abonohu

dhe falënderoi personin që i dha ndihmën e parë, si dhe stafin mjekësor.

Pas ngjarjes, Fahmy tha se përvoja i ka ndryshuar mënyrën se si e sheh jetën. “Duhet ta vlerësojmë jetën, të buzëqeshim, të marrim frymë dhe të mos lejojmë që jeta të na pushtojë”, u shpreh ai. Sipas Qendrave Amerikane për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve, rreth 37 milionë rrufe godasin tokën në SHBA çdo vit, ndërsa rreth 90% e personave që goditen nga rrufeja mbijetojnë.

/vizionplus.tv

#Kamerat #rrufeja

**Ana Miha**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh



BOTA

**Tragjedi! Përmbyset anija me pasagjerë,...**

Xhuljana Zhuleku · 5 orë më parë



BOTA

**Zjarr masiv në Kroaci, evakuohen 230...**

Xhuljana Zhuleku · Dje 19:36



BOTA

**Trump: Lufta me Iranin do të...**

Xhuljana Zhuleku · Dje 18:51

Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

• LIVE

**Lajme**
- Politikë
- Bota
- Vendi
- Kronikë
- Lifestyle

**Programe**
- Programe
- Seriale
- Guida TV
- Video
- Ekipi i Vizion Plus

**Rrjeti**
- Rreth nesh
- Karriera
- Kontakt
- Reklamo me ne
- Dërgo lajmin tënd

**Ligjore**
- Kushtet e përdorimit
- Privatësia
- Cookies
- Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.